
4XX BLOKU I VARIANTEVE TË PIKËQASJEVE

LISTA E FUSHAVE

- 400 Varianti i pikëqasjes – emër vetjak
- 410 Varianti i pikëqasjes – emër organizate
- 415 Varianti i pikëqasjes – emër i njësisë politike-territoriale ose emër gjeografik
- 420 Varianti i pikëqasjes – emër familje
- 430 Varianti i pikëqasjes – titull
- 440 Varianti i pikëqasjes – emër/titull
- 443 Varianti i pikëqasjes – emër/titull konvencional për tekstet ligjore dhe fetare
- 450 Varianti i pikëqasjes – emër i përgjithshëm
- 480 Varianti i pikëqasjes – forma, zhanri ose karakteristikat fizike

Bloku përmban variantin e pikëqasjes. Nga secila fushë 4XX mund të gjenerohet udhëzimi, që drejton përdoruesin nga varianti i pikëqasjes tek pikëqasja e njësuar në fushën 2XX (shenja për referim shih).

Fushat 4XX kanë tregues të njëjtë me fushat 2XX dhe gjithashtu shumica e nënfushave janë të njëjta. Për këtë arsye të fushat 4XX përshkrimet e nënfushave të njëjta nuk përsëriten.

Në fushat 4XX mund të përdoren këto nënfusha të kontrollit:

2	<i>Kodi i sistemit</i>
3	<i>Numri i regjistrimit</i>
5	<i>Kodi për marrëdhënien</i>
7	<i>Shkrimi i pjesës kryesore të pikëqasjes</i>
8	<i>Gjuha e katalogimit</i>
9	<i>Gjuha e pjesës kryesore të pikëqasjes</i>

Përdorimi i nënfushave është përshkruar në kapitullin *Nënfushat e kontrollit* (para bllokut 2XX).